

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË



Nr. 1520 Prot.

Vlorë, më 22/05/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

• **Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse**

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj Shpalljen Publike të shtatë akteve administrativ – Vendimet e kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

• Nr.56, me Nr.1250/2 Prot., datë 13/05/2025; Nr.57, me Nr.1251/2 Prot., datë 13/05/2025;

Nr.58, me Nr.1252/2 Prot., datë 13/05/2025; Nr.59, me Nr.1253/2 Prot., datë 13/05/2025;

Nr.60, me Nr.1254/2 Prot., datë 13/05/2025, të materializuar për subjektin “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjia "Pavarësia", Ap.nr.10, ZK 8602).

• Nr.62, me Nr.1276/2 Prot., datë 19/05/2025; Nr.63, me Nr.1362/2 Prot., datë 19/05/2025, të materializuar për subjektin “Union Marine” sh.p.k me NUIS M16328202S, me seli në Vlorë Bashkëngjitur, gjeni kopje të shtatë akteve të lartcituara - gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) fletë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të shtatë akteve të lartcituara.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1250/2 Prot.

Vlorë, më 13/05/2025

VENDIM Nr.56

Sot, më datë 13/05/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjja "Pavaresia", Ap.nr.10, ZK 8602), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032752, nr.1250 Prot., datë 28/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

KONSTATOVA SE:

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë "Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjislacionin në fuqi", për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë "Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë", protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V janë mbajtur konstatimet përkatëse, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Zyra e Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë.

Nga kontrolli i kryer, rezulton se operatori ekonomik "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V ka importuar makineri me kod Shtesë IP0, Regjimi 4000, me anë të autorizimit nr.14, me nr.19713/1 Ref.,

dt. 31.03.2023, "Për Përrjashtim nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar", mbi bazën e të cilit është përpunuar edhe deklarata doganore IM.4 R 4491, datë 31/03/2023.

Autorizimi nr.14 datë 31.03.2023 për importimin e makinerive të mësipërme është lëshuar në bazë të Ligjit Nr. 92/2014 "Për Tatimin e Vlerës së Shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 56, pika 38, V.K.M nr. 953 dt., 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014" neni 8.

Referuar nenit nr.8, pika 2, të V.K.M nr.953/2014 "Për dispozitat zbatuese të Ligjit nr. 92/2014", përcaktohet shprehimisht se *"Importimi i makinerive dhe pajisjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, vetëm në rastet kur të tilla makineri dhe pajisje importohen në funksion të realizimit të kontratave të investimeve dhe importuesi është vetë personi i tatueshëm që realizon investimin ose përdor makinerinë ose pajisjen"*, pra operatori ekonomik "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V është subjekti i vetëm që përdor makineritë e importuara me përjashtim nga pagesa e TVSH-së në import.

Në nenin 158 pika 2 të ligjit 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shprehimisht se: *"Administrata doganore ka përgjegjësinë për të vlersuar, ngarkuar, kërkuar dhe mbledhur TVSH-në në import, eksport dhe në lidhje me regjimet e tjera doganore, sipas këtij ligji"*. Neni 6 pika 20 të Ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" përcaktohet se *"Detyrim Importi" është detyrimi doganor që duhet paguar në Importimin e mallrave*.

Rezulton se nga ana e Degës së Doganës Vlorë, është proceduar me shkresën nr.3743 Prot., datë 18/12/2024 me lëndë "Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative", si dhe me njoftimin elektronik me email-in e datës 31/12/2024, me lëndë "Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative", me të cilët i është komunikuar subjektit "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V fillimi i procedurës administrative.

Operatori ekonomik "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V, i cili ka përfituar nga lehtësia fiskale e përjashtimit nga pagesa e TVSH në import, ka patur detyrimin ligjor të njoftojë autoritetin doganor – Vlorë mbi çdo ndryshim në veprimtarinë e tij tregtare që lidhet me destinacionin e makinerive dhe pajisjeve të importuara me përjashtim nga pagesa e TVSH-së.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *"Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ"*.

Bazuar në nenin 253 shkronja b dhe c të ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" parashikon si kundërvajtje administrative të kryer me dashje, mos njoftimin e autoriteteve doganore nga operatori, konkretisht *"Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera me dashje: b) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit*

është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28; c) mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit Fletore Zyrtare nr.134, datë 22 gusht 2014 6147 doganor, i detyrimit për të informuar autoritetet doganore pa vonesë për çdo faktor që lind pasi vendimi është marrë nga ato autoritete e që ndikon në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28.

Në nenin 258 pika 1 shkronja 'a' të ligjit 102/2014 dt., 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" citon se: "Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar.

Referuar nenit 261 të këtij ligji, sanksionet e përcaktuar në nenet 256 deri në 259 zbatohen edhe në rastet e kontrolleve pas çlirimit të mallrave (aposteriori). Në mbështetje të kërkesave të nenit 250 pika 1/a dhe pika 4, neni 253/b/c, neni 258/1/a dhe neni 261 të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", operatori ekonomik "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V i llogariten penalitetet në masën e 3 – fishit të detyrimeve doganore në import.

Më tej, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032752, nr.1250 Prot., datë 28/04/2025, në të cilin është parashtruar si vijon : "Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23.01.2025, subjekti "Mirela Truja", i cili ka importuar makineri me përjashtim nga TVSH nuk ka kryer asnjë procedure import/eksport që prej datës 29.07.2023, si dhe nuk ka njoftuar autoritetet doganore për ndërprerjen e aktivitetit ekonomik. Operatori nuk ka respektuar detyrimin ligjor për njoftimin e autoriteteve doganore mbi ndryshimin në veprimtarinë e tij tregtare që lidhet me destinacionin e makinerive të importuara me përjashtim".

Proces verbali i lartcituat, i është njoftuar subjektit me shkresën nr.1250/1 Prot., datë 02/05/2025, me lëndë "Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative", si dhe me email-in e datës 09/05/2025, ora 01:56 AM.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin 92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

V E N D O S A :

- Subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 66,723 (Gjashtëdhjet e gjashtëmijë e shtatëqind e njëzet e tre) lekë.
- Subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V të penalizohet në masën e trefshit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 200,169 (Dyqindmijë e njëqind e gjashtëdhjet e nëntë) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R
Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1251/2 Prot.

Vlorë, më 13/05/2025

VENDIM Nr.57

Sot, më datë 13/05/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjja "Pavaresia", Ap.nr.10, ZK 8602), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032754, nr.1251 Prot., datë 28/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjislacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V është mbajtur konstatimi si vijon : Regjimi i përpunimit aktiv nr. 15164/1 prot., datë 28.10.2022, i autorizuar për prodhimin e “Konfeksione të ndryshme”.

Sistemi i autorizuar : me pezullim; Sasia e vlerësuar: 100,000 copë; Vlera e vlerësuar 4,10,000 euro;

Periudha e vlefshmërisë: 12 muaj; Kufiri kohor për rieksporitim: 240 ditë.

Mallrat që do të vendosen nën regjimin doganor janë me kod tarifor si më poshtë : 0505, 3920, 3923, 3926, 4015, 4203, 4802, 4814, 4906, 5007, 5111, 5204, 5208, 5401, 5407, 5503, 5508, 5512, 5515, 5601, 5801, 5804, 0806, 5810, 5907, 6001, 6101, 6115, 6201, 6502, 7117, 7606, 8308, 9606, 6307, e ndryshuar me shkresën nr. 15840/1 prot., datë 15.11.2022 duke shtuar kodin 4821, 5806, 5903, 9607, shkresa me nr. 15877/1 prot., datë 15.11.2022 duke shtuar kodin 4911, 6204; shkresa me nr 15885/1 port., datë 15.11.2022 duke shtuar kodin 5807, e ndryshuar me shkresën nr. 21598/1 prot., datë 07.06.2023 duke shtuar kodin 6004, e ndryshuar me shkresën nr. 21599/1 prot., datë 07.06.2023 duke shtuar kodin, 5203, 5105, 5506, 5513, 5507, 5112, e ndryshuar me shkresën nr. 17785/1 prot., datë 24.01.2023 duke shtuar kodin 6110, 6203, e ndryshuar me shkresën nr. 17738/1 prot., datë 23.01.2023 duke shtuar kodin 6110, 6203; e ndryshuar me shkresën nr. 16904/1 prot., datë 19.12.2022 duke shtuar kodin 5210; e ndryshuar me shkresën nr. 16505/1 prot., datë 07.12.2022 duke shtuar kodin 3921; e ndryshuar me shkresën nr. 16303/1 prot., datë 30.11.2022 duke shtuar kodin 5211; e ndryshuar me shkresën nr. 16287/1 prot., datë 30.11.2022 duke shtuar kodin 5408, 5603, 5309, 6006, 6104; e ndryshuar me shkresën nr. 16042/1 prot., datë 21.11.2022 duke shtuar kodin 5604; e ndryshuar me shkresën nr. 16450/1 prot., datë 05.12.2022 duke shtuar kodin 6005

Produktet kompensues të përfituara nga përpunimi i lëndëve të para do të jenë sipas kodeve tarifor të mëposhtëm; 6101, 6115, 6201, 6502, 6307, e ndryshuar me shkresën nr. 16436/1 prot., datë 05.12.2022 shtohen kodet NK 6204, 6104, 6113. Në fund të periudhës, situata/bilanci material i autorizimit sipas sistemit oracle/ database kombëtar paraqitet si më poshtë: Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi	Procedura	P. Neto	VI. Fat.	Tax. Dog
a	Import 5	5100	5,255.71	115,953.00	179,123
b	Import 5	5151	99.76	1,646.06	0
c	Import 5	5171	1,675.31	53,071.98	80,271
d	Export 3	3151	6,866.59	163,352.14	0
e	Totali (a+b+c-d)		164.19	7,318.90	259,394.00

Referuar tabelës së mësipërme – bilanci material i autorizimit nuk rezulton i mbyllur për, sasinë 164.19 kg me vlerë 7,318.90 euro dhe taksën doganore 259,349 lekë.

Në dosjen e operatorit ishte shkresa pa nr. protokolli, e datës 18.01.2024 “Kërkesë për ndryshime të deklaratave doganore” konkretisht deklaratat doganore exp. 3 me nr. R12412, datë 03.02.2023, R14444, datë 08.02.2023 dhe R 46337, datë 15.04.2023. Në lidhje me këto praktika operatori kërkon të amendojë sasinë në kg të eksportuara dhe vlerën e materilave të trupëzuara në produktin kompensues të eksportuara. Këto në bazë të faturave të bashkangjitura praktikave doganore të mësipërme. Në shqyrtim të praktikave të mësipërme sasinë në kg dhe vlerë të pasqyruara në faturat bashkangjitur deklaratave janë në përputhje me deklaratat doganore eksport 3 të mësipërme. Si rrjedhojë kjo kërkesë edhe nëse do të ishte me nr. __, protokolli nuk duhet të merret në konsideratë.

Referuar të dhënave të sistemit asycuda world/oracle operatori nuk është ripajisur me autorizim të ri të regjimit përpunimit aktiv. Sipas të dhënave, veprimi i fundit doganor në eksport është deklarata doganore me nr. R98465, datë 29.07.2023 dhe në import është deklarata me nr. R72021, datë 07.06.2023. Afati i rieksporitit është 240 ditë, si rrjedhojë periudha e rieksporitimit ka përfunduar më datë 02/02/2024. Referuar dosjes së operatorit pranë Degës Vlorë, operatori nuk ka njoftuar autoritetet doganore për ndonjë faktor që të ketë ndikuar në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 28 të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar.

Grupi i auditimit për diferencën në sasinë 164.19 kg me vlerë 7,318.90 lekë, vlerëson se nga ana e opertaorit është konsumuar kundërvajtja administrative e parashikuar nga nenet 250/1/a, 252/c e Kodi Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të nenit 257, pika 1/a dhe pika 2 të ligjit nr.102/2014 “Kodit Doganor i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, pra operatori ekonomik “Mirela Truja”, duhet të paguajë detyrimin e përlogaritur në shumën 146,832 lekë dhe penaltitet dyfishin e detyrimit në shumën 293,664 lekë. Përlllogaritja e detyrimeve jepet sipas tabelave të mëposhtme:

Txt Rsv_20221028/15164/1			
Sasia kg	Vlera Euro	Kursi	Baza
164.19	7,318.90	100.31	734,159
Detyrimi TVSH 20%			146,832

Detyrimi Doganor, Lekë	Penalitet	Totali Lekë
146,832	293,664 lekë, 2-fishi i detyrimit, Neni 257 pika 1/a dhe pika 2	440,496

Më tej, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbal i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032754, nr.1251 Prot., datë 28/04/2025, në të cilin është parashtruar si vijon : *“Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23.01.2025, subjekti “Mirela Truja” i pajisur me autorizimin e RPA Nr.15164/1 dt 28.10.2022, nuk ka mbyllur autorizimin për sasinë 164,19 kg me vlerë 7318,9 Euro. Për sasinë prej 164,19 kg me vlerë 7318.9 euro është përlllogaritur detyrimi doganor 146,832 lekë”*. Proces verbal i lartcitur, i është njoftuar subjektit me shkresën nr.1251/1 Prot., datë 02/05/2025, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative”, si dhe me email-in e datës 09/05/2025, ora 01:56 AM. Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;*

Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : *1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;*

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin Nr.4 datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

V E N D O S A :

- Subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 146,832 (Njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjet e dy) lekë.
- Subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 293,664 (Dyqind e nëntëdhjet e tremijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e katër) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vënien e mallrave përkatës në regjimin doganor të duhur, konform përcaktimeve të legjislacionit doganor për regjimin në fjalë.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar 100% penaltetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1252/2 Prot.

Vlorë, më 13/05/2025

V E N D I M N r . 5 8

Sot, më datë 13/05/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjja "Pavaresia", Ap.nr.10, ZK 8602), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032755, nr.1252 Prot., datë 28/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

K O N S T A T O V A S E :

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë "Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjisilacionin në fuqi", për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë "Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë", protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit "Mirela Truja" p.f me NUIS L97417202V është mbajtur konstatimi si vijon : *"Në auditim të dosjes të operatori ekonomik konstatohet mungesa e dokumentit të mbylljes së regjimit (Aneksi 8) brenda afatit ligjor të parashikuar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 550 "Dokumentit të mbylljes së regjimit" i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të kreu XIV/pika 2 dhe kreu XV/pika 1/paragrafi 9, pika 2 dhe 3 të*

Udhëzimit nr. 4, datë 28.03.2019 "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv", i ndryshuar, duke konsumuar kundërvajtje administrative të parashikuar shprehimisht nga neni 252/c, i ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit kundërvajtja duhet të duhet të klasifikohet "kundërvajtje në neglizhencë":

c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Për këtë shkelje duhet të aplikohet një gjobë në shumën 50,000 lekë në mbështetje të nenit 257/1/b të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".

Më tej, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032755, nr.1252 Prot., datë 28/04/2025, në të cilin është parashtruar si vijon : "Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23.01.2025, subjekti "Mirela Truja" i pajisur me autorizimin e RPA Nr.15164/1 dt 28.10.2022, nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes së Autorizimi (Aneksi 8)".

Proces verbali i lartcituar, i është njoftuar subjektit me shkresën nr.1252/1 Prot., datë 02/05/2025, me lëndë "Njoftim i proces – verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative", si dhe me email-in e datës 09/05/2025, ora 01:56 AM. Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcituar dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : "Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ".

Neni 252 shkronja "c" parashikon si vijon : Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm : b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë. Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin Nr.4 datë 28.03.2019 "Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv",

VENDOSA:

- Subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V të penalizohet në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penaltitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.1253/2 Prot.

Vlorë, më 13/05/2025

VENDIM Nr.59

Sot, më datë 13/05/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pasi shqyrtova rekomandimin e lënë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i mbajtur në ngarkim të subjektit “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V, me ushtrim të aktivitetit në Vlorë (Rajoni nr.2, Lagjja "Pavaresia", Ap.nr.10, ZK 8602), si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032756, nr.1253 Prot., datë 28/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit,

KONSTATOVA SE:

Në mbështetje të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (i ndryshuar), Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), Planit të auditimeve për vitin 2024, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave me shkresën nr.17278/3 Prot., datë 20.10.2023, si dhe programit të angazhimit të auditimit, të miratuar me shkresën nr.12640/3 Prot., datë 10/06/2024, Grupi i auditimit i përbërë nga inspektorët e autorizuar të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, përfunduan misionin e auditimit të përputhshmërisë në Degën e Doganës Vlorë “Vlerësimi i pavarur i funksionimit të sistemeve të ngritura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik që operojnë në Doganën Vlorë, vlerësimi i veprimtarisë së saj në këndvështrimin e përputhjes me legjisilacionin në fuqi”, për periudhën kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Pas përfundimit në terren, në zbatim të pikës 4.1.11 të Urdhërit të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcjellë pranë nesh shkresën nr.12640/5 Prot., datë 21.11.2024 me lëndë “Dërgohet projekt raporti për auditimin e kryer në Doganën Vlorë”, protokolluar me Tonën me nr.1666/3, datë 25.11.2024, ku midis të tjerave, ndaj subjektit “Mirela Truja” p.f me NUIS L97417202V është mbajtur konstatimi si vijon : *“Për diferencën e taksës doganore, nga të dhënat e sistemit Asycuda World, u konstatua se operatori ka rieksportuar pordukt kompensues të pajisur me certifikatë Eur.1 “Made in Albania” dhe eksporte të pa pajisur me certifikatë Eur.1. Të dhënat e deklaratave të eksportit, deklarata të pa pajisur me certifikatë Eur.1 jepen sipas tabelës të mëposhtme :*

Tst Rsv_ 20221028/15164/1											Tar Pre Est		Imp. 5 që shkarkohen me deklaratat e eksportit				
											3151		Tst Rsv_ 20221028/15164/1				
Date	DAV	Tip	NO	NK4	NK8	Pershkrimi	Mon	Kurs	Origj	Tar Prf	P. Net	Vlera	DAV Imps	Data	Pesha, kg	Vlera, Euro	Taxa Lekë
30/12/2022	165525	EX	3	6204	62046990	KAMPIONATURA 1 COPE	EUR	116.86	IT	(blank)	0.6	15					Pa taksa
03/02/2023	12412	EX	3	6204	62045990	KAMPIONATURA =4 CP	EUR	114.23	AL	(blank)	0.99	50					Pa taksa
						CP,PANTALLONA=271 CP											
15/02/2023	18072	EX	3	6204	62046290	KAMPIONE=2 CP	EUR	116.55	AL	(blank)	42.9	1071.2					
													816	21.01.2023	157	5,843	Pa taksa
													1546	07.02.2023	156	3,531	Pa taksa
10/04/2023	44113	EX	3	6204	62046990	PANTOLLONA TE QEPURA 700 C	EUR	113.21	AL	(blank)	455	6328	33656	19.03.2023	1,228	14,942	153,910
15/04/2023	46337	EX	3	6204	62046918	PANTOLLONA TE QEPURA 1262	EUR	113.21	AL	(blank)	858.16	11386	33656	19.03.2023			
													25138	02.03.2023	377	11,418	1,772
22/04/2023	49879	EX	3	6204	62046290	KAMPIONE TE QEPURA 4 CP	EUR	113.21	TR	(blank)	2.75	58					Pa taksa
03/06/2023	70194	EX	3	6204	62044990	KAMPIONE 2 CP	EUR	111.12	IT	(blank)	1.5	85					Pa taksa
29/07/2023	98465	EX	3	6204	62044990	PANTOLLONA TE QEPURA 851 C	EUR	100.49	AL	(blank)	449.64	13914	52365	28.04.2023	312	10,751	Pa taksa
Grand Total											1812	32907	Totalit		2,230	46,485	155,682

Nga auditimi sipas të dhënave të sistemit asycuda world/oracle, të gjitha eksportet e tjera janë eksporte të pajisur me certifikatë Eur. 1, origjinë AL. Për sa mësipër, bazuar në nenin 73, pika 1 të Kodit Doganor të RSH, në të cilin parashikohet shprehimisht: “Kur zbatohet ndalimi i rimbursimit ose përjashtimi nga detyrimet e importit për mallrat jo-origjinuese, që janë përdorur në prodhimin e produkteve, për të cilat është lëshuar një provë origjine në kuadër të një marrëveshjeje preferenciale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe disa vendeve, territoreve ose grup-vendeve ose territoreve të vendosura jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, një borxh doganor importi lind në momentin e pranimit të deklaratës doganore të rieksporit për këto mallra”, si dhe pikën 14 të Udhëzimit nr.1, datë 06.09.2012 “Për zbatimin praktik të RPA”, i ndryshuar dhe pikën XII “Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës” të udhëzimit nr.4, datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të RPA”, mallrat jo origjinuese të trupëzuara në produktet e përpunuara të cilat kanë përfituar origjinë preferenciale shqiptare duhet t'i nënshtrohen pagimit të taksës doganore preferenciale.

Grupi i auditimit në mbështetje të neneve 252/c dhe 257/1/a, të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 260, “Kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë”, kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas, vlerëson se operatori ekonomik “Mirela Truja” duhet të paguajë taksën doganore të papaguar në eksport në shumën totale 103,712 lekë detyrim TDP (259,394 lekë – 155,682 lekë) dhe dyfishin e detyrimit doganor si penaltet në shumën 207,424 lekë”.

Për konstatimin e lartcitur, Dega e Doganës Vlorë, bazuar në nenin 41 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e ka njoftuar subjektin mbi fillimin e procedurës administrative, me anë të shkresës nr.3743 Prot., datë 18/12/2024, me lëndë “Njoftim mbi fillimin e procedurës administrative”, me të cilën i ka kërkuar subjektit paraqitjen e të gjithë dokumentacionit, informacionet përkatëse, provat, mendimet, shpjegimet e mundshme, kundërshtimet,

propozimet etj, të cilat hedhin dritë mbi veprimet e kryera nga ana Juaj për regjimin doganor të lartpërmendur.

Më tej, nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, është dërguar shkresa me Nr.12640/6 Prot., datë 23/01/2025, protokolluar me Tonën me nr.1666/7, datë 24/01/2025, me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e kryer në Degën Doganore Vlorë”. Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, nga Dega e Doganës Vlorë u hartua “Plani i Punës” me nr.1666/7 Prot., datë 07/02/2025, duke parashikuar në të, masat dhe Zyrat (personat) përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e detyrave konkrete. Nga ana e Grupit të Punës është kryer rishqyrtimi i rekomandimit të lënë ndaj këtij subjekti.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shyrtrim të rekomandimit, është mbajtur Proces – Verbal i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032756, nr.1253 Prot., datë 28/04/2025, ku në pjesën përshkuese është parashtruar si vijon : *“Referuar Raportit Përfundimtar të Auditit Nr.12640/6 dt. 23/01/2025, subjekti “Mirela Truja” i pajisur me autorizimin e RPA Nr.15164/1 dt 28.10.2022, nuk ka paguar taksën doganore në eksport të origjinës preferenciale në shumën 103,712 lekë”*.

Subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur, pasi është njoftuar me anë të korepondencës elektronike më datë 09/05/2025, si dhe me anë të shkresës nr.1253/1 Prot., datë 02/05/2025, me lëndë “Njoftim i proces verbalit për verifikimin e kundërvajtjes administrative” dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij. Rezulton e provuar se subjekti ka kryer kundërvajtje administrative të kryer me neglizhencë.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : “Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose mosveprimet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje të kryera në neglizhencë : c) mosrespektimi nga personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

